

AKT THEMELIMI

Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
“FRIENDLY SERVIS” SH. P. K.

Sot, më datën 03.09.2024, **Z. Artan Bakanaçi**, i lindur në Sukth, datë 28 Maj 1978, mbajtes i kartes se identitetit me numer 036971245, banues ne Katund Sukth, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, **Z.Denis Kulla** i lindur ne Durres, date 14 Shkurt 1986, banues ne Durres, mbajtes i kartes se Identitetit me Nr.033375601, madhor me zotesi te plote per te vepruar, vendosën të themelojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “*FRIENDLY SERVIS*” Sh. P. K. si më poshtë vijon

Neni 1

Personat fizikë të sipërpërmendur, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, krijojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (Sh. P. K.) me emërtimin “*FRIENDLY SERVIS*” SH.P.K

Ortakë të kësaj shoqërie janë **Z. Artan Bakanaçi dhe Z.Denis Kulla**.

Administrator i kësaj shoqërie caktohet **Z. Artan Bakanaçi**.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saja brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që do të vlerësohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

Neni 2

Shoqëria “*FRIENDLY SERVIS*” Sh.P.K gëzon statusin juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Sh. P. K.”. Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi.

Qendra e saj është Durres, Rruga “Xhelal Memoci” . 00830150, Ndertese me nr. Pasurie 35, ZK.3255, Sallmone, Shijak, Durres.

Statuti i shoqërisë i bashkangjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Shoqëria ka vulën e saj me logon dhe të dhënat të përcaktuara.

Neni 3

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë kohe te pa caktuar.

Neni 4

Shoqëria do të kryejë aktivitetet me objekt:

- Tregeti me shumice e pakice te mallrave te ndryshem industriale, pjese kembimi, servis per riparime te automjeteve te te gjitha llojeve dhe tipeve te ndryshme, duke perfshire ketu autovetura dhe makina te cdo lloji dhe tonazhi, shitje te pjeseve te kembimit per autoveturat dhe automjetet e te gjitha llojeve.
- Shitje-blerje me shumice dhe pakice te makinave dhe autoveturave te te gjitha llojeve dhe tonazheve,
- Dhenie me qira e automjeteve,
- Tregeti te aksesoreve te automjeteve te te gjitha llojeve.

- Lavazh per automjete
- Magazinimi i artikujve te ndryshem per shitje
- Impiante gazi
- Siguracione per makina
- Mbledhja , depozitimi, shkaterrimi i mjeteve ose pjeseve te tyre te dala jashte perdorimit ose te braktisura.
- Sherbim dhe tregti te gomave te te gjithë kategorive, Veshje xhamash autojmetesh.
- Ofrim sherbimi si pergjegjes teknik i aktivitetit te autoriparimit

Neni 5

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 Leke. Kapitali i shoqerise ndahet ne nje numer kuotash ne raport me kontributin e dhene nga cdo ortak ne shoqeri ku cdo ortak zoteron nje kuote te vetme ne shoqeri, kuota keto te shlyera i mëposhtë:

Z. Artan Bakanaçi zotërues i nje kuote me vlere të përgjithshme 51.000 leke që përben 51% të kapitalit të shoqërisë.

Z. Denis Kulla zotërues i nje kuote me vlere të përgjithshme 49.000 leke që përben 49% të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme ose te paluajtshme apo te drejta). Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 6

Fitimi neto nga aktiviteti i kësaj shoqërie i përket ortakeve të saj.

Neni 7

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie, do të përgjigjet vetë shoqëria deri në kufirin maksimal të kapitalit të saj.

Neni 8

Marrëdhëniet e punës në shoqëri dhe në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

Neni 9

Dispozita të hollësishme mbi organinzimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj. Themeluesit e kësaj shoqërie, pasi e lexuan me vëmendje këtë akt themelimi dhe e gjetën në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me vullnetin e tyre, e firmosën pa vërejtje.

ORTAKËT E SHOQËRISË.

ARTAN BAKANAÇI

DENIS KULLA